



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 948 prot.

Himarë, më 20.02.2024

PROJEKTVENDIM

Nr. 7 datë, 20.02.2024

“MBI KRIJIMIN E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN TË KËSHILLIT TË BASHKISË HIMARË”.

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54 gërma a.

Me propozim të Kryetarit të Këshillit të Bashkisë Himarë si dhe në zbatim të vendimit nr.03, datë 31.01.2024 të këshillit Bashkiak Himarë dhe shprehjes së ligjshmërisë të këtij vendimi nga prefektura e Qarkut Vlorë me nr. 673 prot, më datë 21.02.2024, dhe në mbështetje të ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, propozon ngritjen e grupit të këtij këshilli për krijimin e komisionit të integrimit evropian të Këshillit të Bashkisë Himarë dhe në përfundim:

VENDOSI:

1. Të krijohet komisioni i integrimit evropian i Këshillit Bashkiak si më poshtë:

1-Komisioni i integrimit evropian

- 1.
- 2.
- 3.
- 4.
- 5.

1.Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Bashkisë Himarë

2.Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.



KRYETARI

Dhimitër Kapaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 948 / prot.

Himarë, më 2002 .2024

RELACION SQARUES

“PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN”

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” , neni 54 gërma “a” sipas vendimit të Këshillit Bashkiak nr.03, miratuar më datë 31.01.2024 si dhe bazuar në shprehjen e ligjshmërisë së këti vendimi nga prefektura e Qarkut Vlorë me nr. ___ prot, vendosëm të bëhet ky ndryshim dhe kjo shtesë në tekstin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e këshillit Bashkiak.

Në tekstin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Himarë, të miratuar me VKB-në nr.33, datë 28.07.2023 , VKB-në nr 03 datë 31.01.2024, në nenin 32, me 6 komisionet e përhershme të Këshillit shtohet edhe komisioni i integritimit evropian.

Komisioni i integritimit evropian të përbëhet nga pesë (5) këshilltarë, tre nga shumica dhe dy nga pakica, dhe të ngrihet me vendim të Këshillit Bashkiak kur votojnë “Pro” shumica e Këshilltarëve. Në përcaktimin e përbërjes së Komisionit respektohen kërkesat e barazisë gjinore. Propozimet për anëtarët e Komisionit bëhen nga kryetarët e Grupeve të Këshilltarëve të cilët ia paraqesin Kryetarit të Këshillit.

Komisionit i integritimit evropian do të jetë përgjegjës dhe ka të drejtë :

- Të mbështesë dhe koordinojë strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i anëtarimit në BE.
- Të monitoroj programimin dhe zbatimin me efikasitet të gjithë financimeve në kuadër të programeve të BE-së dhe donatorëve të tjerë, nga të cilat përfiton bashkia.
- Komisioni merr në shqyrtim raportin e vlerësimit të performancës së bashkive në procesin e integritimit evropian i cili hartohet dhe raportohet çdo vit kalendarik.
- Këshilltarët janë pjesë e aktiviteteve që Kryetari i Bashkisë, me mbështetjen e strukturës së Integritimit Evropian, organizon në Bashki, në bashkëpunim me strukturat e qeverisë qendrore, Delegacionin e BE në Tiranë, si dhe përfaqësitë e vendeve anëtare të BE-se.
- Këshilltarët njihen me ecurinë e projekteve të financuara nga fondet e BE-se, të cilat janë pjesë e projekteve të bashkisë dhe donatorëve të tjerë, nëpërmjet raporteve të përgatitura 2 herë në vit nga administrata e bashkisë.
- Këshilltarët mund të kërkojnë një seancë konsultimi me të gjithë aktorët lokalë dhe Kryetarin e Bashkisë për të diskutuar rezultat mbi performancën e bashkisë bazuar në vlerësimin vjetor të performancës së bashkive në procesin e integritimit evropian, si dhe masat që duhet të ndërmerren për ato aspekte të vlerësimit ku Bashkia duhet të përformoj më mirë.

SEKRETARI KËSHILLIT

Elena Memushaj

